



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 400-32017/16
Kaçanik, 28.09.2016

Në mbështetje të nenit 24 lidhur me nenin 40.2(b) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 61. të Ligjit nr.03/L-048. – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 2 të Ligjit nr.03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal, si dhe nenit 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 28 Shtator 2016, mori këtë:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITIN FISKAL 2017
DHE VLERËSIMET PËR VITET 2018 - 2019

1. Buxheti i përgjithshëm i Organizatës Buxhetore të Komunës së Kaçanikut, për vitin buxhetor 2017 është në shumë, 7,039,281 € , ndërkaq Vlerësimet e projektuara për vitin 2018 janë në shumë, 7,212,680 € dhe për vitin 2019 në shumë, 7,359,438 €.
2. Në strukturën e të hyrave të tërësishme buxhetore për vitin buxhetor 2017., sipas pikës 1. të këtij Vendimi, mjetet nga Grantet qeveritare në shumë, 6,178,267 € , shënojnë pjesëmarrje me, 87,7% dhe të Hyrat vetjake komunale, në shumë, 861,014 €, me një pjesëmarrje, 12,3% në strukturën e përgjithshme të buxhetit.
3. Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin buxhetor 2017, parashikohen të jenë të ndarë për Shpenzime Rrjedhëse shuma, 5,714,255 € dhe Shpenzime Kapitale, shuma, 1,325,026 €.
4. Shpenzimet totale buxhetore për vitin 2017, sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve, parashikohet të kenë këtë ndarje :

1. Pagat, Mëditjet dhe kompensimet tjera	4,831,215 €
2. Shpenzimet e Mallrave dhe Shërbimeve	359,350 €
3. Shpenzimeve Komunale	139,000 €
4. Subvencionet dhe Transferet	204,690 €
5. Shpenzimet në Investimet Kapitale	1,325,026 €
5. Për zbatimin dhe rishikimin e këtij Vendimi mbi buxhetin e komunës, obligohet Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës dhe do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.
7. **Vendimi u dërgohet:** Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim- përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante, dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi